



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 15 nëntor 2021
Nr.ref.:RK 1894/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI81/21

Parashtrues

Byroja Kosovare e Sigurimit

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit Rev. nr.445/2020 të
Gjykatës Supreme, të 10 shkurtit 2021**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar.

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Byroja Kosovare e Sigurimit, e përfaqësuar nga Faik Sylejmani (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktgjykimit [Rev.nr.445/2020] të 10 shkurtit 2021 të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, përmes së cilit pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) dhe nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 4 të nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe paragrafët 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

5. Më 5 maj 2021, Gjykata Kushtetuese e Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, e cila ishte dorëzuar në postë më 29 prill 2021.
6. Më 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21 u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, më 26 qershor 2021.
7. Më 18 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës Arta Rama Hajrizi caktoi gjyqtaren Selvete Gërxhaliu-Krasniqi gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Radomir Laban (kryesues), Remzie Istrefi-Peci dhe Nexhmi Rexhepi.
8. Më 20 maj 2021, Gjykata e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi që të dorëzojë në Gjykatë autorizimin për përfaqësim në Gjykatë.

9. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së punës, gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
10. Më 1 qershor 2021, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi në Gjykatë autorizimin për përfaqësuesin para Gjykatës.
11. Më 3 qershor 2021 Gjykata i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme.
12. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani morri detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtarës së Gjykatës Kushtetuese.
13. Më 20 tetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

14. Më 14 korrik 2007, në rrugën rajonale Rozhajë –Pejë, kishte ndodhur një aksident trafiku pasi i ndjeri G.B. i cili drejtonte veturën BMW me tabela suedeze, pronë e B.G., kishte humbur kontrollin e veturës me ç'rast si pasojë e aksidentit kishin humbur jetën drejtuesi i veturës G.B., pronari i veturës B.G., si dhe B.Sh. Vetura e aksidentuar ishte e siguruar tek parashtruesi i kërkesës me "sigurim kufitar" për mbulimin e dëmeve ndaj palëve të treta, gjatë kohës së qëndrimit në Kosovë.
15. Në një datë të pasaktësuar, A.G. dhe G.G., prindërit e të ndjerit B.G., pronarit të veturës së aksidentuar (në tekstin e mëtejme: paditësit) kishin paraqitur padi kundër parashtruesit të kërkesës duke kërkuar nga kjo e fundit zhdëmtim material si pasojë e aksidentit të lartcekur, dhe atë: i) në emër të veturës së dëmtuar shumë prej 10.394.00 euro; ii) në emër të mbajtjes së humbur ndaj paditësve dhe atë paditësit A.G. shumë prej 62.825.00 dhe paditëses G.G. shumë prej 85.010.00 euro; si dhe iii) shpenzimet procedurale në shumë prej 4.598.00 euro.
16. Më 10 korrik 2015, Gjykata Themelore në Pejë (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore) përmes Aktgjykimit [Cnr.949/14] e refuzoi si të pabazuar padinë e paditësve ndaj parashtruesit të kërkesës. Gjykata Themelore gjeti se: i) sipas Rregullit 3 për ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia (në fuqi në kohën e kryerjes së aksidentit) në rast të aksidentit, pronari i automjetit, nuk ka të drejtë në kompensimin e automjetit të dëmtuar; ii) paditësit nuk ishin në gjendje të argumentojnë se i ndjeri B.G. ka qenë person që ka realizuar të ardhura dhe është përkujdesur për mbajtjen e paditësve

(prindërve të tij); dhe *iii*) paditësve nuk u takojnë shpenzimet procedurale pasi janë palë humbëse në këtë kontest.

17. Në një datë të paspecifikuar, paditësit parashtruan ankesë në Gjykatën e Apelit të Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata e Apelit) kundër Aktgjykimit të lartcekur të Gjykatës Themelore, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që Aktgjykimi i atakuar të ndryshohet ashtu që të aprovohet padia ose të anulohet dhe çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur përgjigje në ankesë.
18. Më 17 nëntor 2019, Gjykata e Apelit, përmes Aktgjykimit [Ac.nr.3553/2015], refuzoi si të pabazuar ankesën e paditësve duke e konfirmuar Aktgjykimin [Cnr.949/14] të Gjykatës Themelore.
19. Në një datë të paspecifikuar, paditësit parashtruan revizion kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit në Gjykatën Supreme duke pretenduar shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që revizioni të aprovohet si i bazuar dhe Aktgjykimet e gjykatave më të ulëta të ndryshohen ashtu që të aprovohet padia ose çështja të kthehet në rivendosje. Parashtruesi i kërkesës nuk kishte paraqitur përgjigje në revizion.
20. Më 10 shkurt 2021, Gjykata Supreme përmes Aktgjykimit [Rev.nr.445/2020]: (i) e pranoi pjesërisht revizionin e paditësve, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që paditësve: (i) në emër të shpërblimit të dëmit material për dëmtimin e veturës, t'ua kompensojë shumën prej 10,394.00 euro me kamatë që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke e llogaritur nga data e përpilimit të ekspertizës së 27 korrikut 2012; (ii) t'ua kompensojë shpenzime procedurale në shumën prej 5,598.00 euro; dhe (iii) në pjesën tjetër, refuzoi revizionin si të pabazuar.
21. Gjykata Supreme, sa i përket pretendimit të paditësve lidhur me kompensimin e dëmit material për automjetin e aksidentuar dhe shpenzimet procedurale, arsyetoi se sipas nenit 1.8 pika (c) të Rregullës 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë është përcaktuar që personat që nuk kanë të drejtë në shpërblimin e dëmit në bazë të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë, që nuk kanë statusin e personit të tretë, janë: pronari, bashkëpronari dhe shfrytëzuesi i regjistruar i automjetit nëse bëhen dëme në pasurinë e tyre. Lidhur me këtë, Gjykata Supreme gjeti se nga interpretimi ligjor dhe gramatikor i dispozitës së lartcekur, qartë rezulton se kur pronari i automjetit është bashkudhëtar, i njihet e drejta për shpërblimin e dëmit dhe statusi juridik nuk mund të jetë ndryshe nga statusi i udhëtarëve të tjerë. Për këtë arsye, sipas Gjykatës Supreme e drejta e shpërblimit të dëmit në automjet duhet të pranohet. Sipas Gjykatës Supreme, nga kjo mund të konkuldohet se pronari i automjetit ka të drejtë në shpërblimin e dëmit nëse ka qenë bashkudhëtar në automjet. Gjykata Supreme po ashtu arsyetoi se për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në automjet, paditësit kanë të drejtë në shpërblimin e dëmit në bazë të nenit 178 të Ligjit për

Marrëdhëniet e Detyrimeve të vitit 1978 (në tekstin e mëtejshëm: LMD e vitit 1978). Sa i përket shpenzimeve procedurale, Gjykata Supreme vendosi se të gjitha shpenzimet t'i bartë parashtruesi i kërkesës duke llogaritur lartësinë e shpenzimeve sipas listës së precizuar nga i autorizuari i paditësve e llogaritur sipas tarifës së avokateve pasi nuk ka pasur shpenzime të veçanta, në kuptim të nenit 452.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në tekstin e mëtejshëm: LPK).

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

22. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi [Rev.nr.445/2020] i 10 shkurtit 2021 i Gjykatës Supreme është nxjerrë në shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të tij të garantuara përmes neneve 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës dhe nenit 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ.
23. Lidhur me të drejtën për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, parashtruesi i kërkesës, thekson se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim adekuat gjithëpërfshirës me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë për shumat e gjykuara në emër të dëmit material në automjet, respektivisht në mënyrë arbitrare ka vendosur për t'ia njohur një të drejtë e cila në vetvete paraqet cenim të parimeve themeltare kushtetuese. Në këtë kontekst, parashtruesi i kërkesës thekson se ky i fundit *“ushtroi veprimtarinë [...] ligjore për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga automjetet pa sigurim, nga automjetet e paidentifikuara, ato me sigurim kufitar ashtu sikurse kishte kontraktuar edhe tanime i ndjeri [B.G] (i biri i paditësve). Kontraktimi i policës së sigurimit në mes të ndjerit dhe [parashtruesit të kërkesës], në kuptim të dispozitave të lartcekura, palët kontraktuese janë dakorduar [...] se për çdo dëm që eventualisht ndodhë ndaj ndonjë pale të tretë të shkaktuar nga i ndjeri do të mbulohen nga [parashtruesi i kërkesës]. Mirëpo duke qenë se dëmi i shkaktuar nga ky aksident trafiku i është shkaktuar veturës së të ndjerit, cilësia e palës së tretë humbet dhe se një dëm nga një veteaksident si në rastin konkret nuk mund të kompensohet në dobi të paditësve si trashëgimtar të pasurisë (veturës) nga [parashtruesi i kërkesës], për faktin se u mungon elementi esencial i detyrimeve kontraktuale, për faktin se detyrimet sipas aktgjykimit të atakuar ndërliken me pronësinë e automjetit të kontraktuar me polisë sigurorese të lëshuar nga Byroja e cila ka efekt për palën e tretë, e jo edhe për policën e lëshuar për automjetin e cila është objekt kontesti. Një dëm i tillë do të mund t'i takonte nga polisa kasko e sigurimit, gjë që [parashtruesi i kërkesës] nuk ofron një shërbim të tillë”*.
24. Parashtruesi i kërkesës argumentet për mosarsyetim të vendimit dhe arbitraritet nga ana e Gjykatës Supreme i ndërton duke u bazuar në kuptim të nenit 1.8, pika c) të Rregullit 3 mbi Ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë si dhe Ligjin nr. 04/L-018 për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia, përmes së cilave përjashtohet mbulesa sigurorese pasi të njëjtën nuk kanë cilësinë e “personit të tretë”. Lidhur me këtë ai shton se *“[n]ë mënyrë që kontrata e sigurimit në dobi të personit të tretë të jetë e vlefshme, duhet që personi i tretë, të jetë i huaj, domethënë, të mos jetë palë në lidhjen e kontratës, si dhe të mos ketë interes pasuror në objektin e siguruar. Në këtë kontekst*

kontrata e sigurimit është kontratë aleatore ose fatore, domethënë, që është një kontratë e cila karakterizohet nga përcaktueshmëria, efektet juridike të kontratës së sigurimit shtrihen tek një kategori personash që kanë cilësinë e të dëmtuarit në aksidentet automobilistike, gjegjësisht që kanë cilësinë e personit të tretë. Këto janë përfituesit e kontratës së sigurimit të cilët në legjislacionin civil njihen si persona të tretë.” Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës bazohet edhe në nenin 4 të “Konventës së Strazburgut, 30 prill 1959” e cila sipas tyre paraqet një udhërrëfyes të zbatimit të kontratave të sigurimit, dhe e konfirmon të njëjtin parim lidhur me personat e tretë, dhe rastet kur përjashtohet shpërblimi i dëmit për kontraktuesit e sigurimit dhe anëtarët e familjes së tyre.

25. *Më tej, parashtruesi i kërkesës thekson se “Në bazë të dispozitës së nenit 86 të Ligjit Mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (1978) dhe nenit 74 të Ligjit [04/L-077] mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (201[2]) rregullon raportet si në vijim: Përfaqësuesi nuk mund të bëjë bartjen e autorizimeve të veta në tjetrin, përveç nëse kjo i është lejuar me ligj ose me kontratë”.*
26. *Parashtruesi i kërkesës po ashtu i referohet edhe nenit 131 të LMD-së të vitit 2012 duke theksuar se në nenin e lartcekur parashihet se “Kontrata në dobi të personit të tretë (pactum in favorem terti) është një kontratë e tillë detyruese me të cilin njëra palë kontraktuese (promitenti) i detyrohet palës tjetër kontraktuese (stipulantit) t’ia përmbushë ndonjë detyrim jo bashëkontraktuesit të vet, por ndonjë palë të tretë (shfrytëzuesit) me así efekti juridik që pala e tretë përmbushjen e detyrimit mund ta kërkojë në mënyrë të pavarur dhe drejtpërdrejtë nga promitenti, edhe pse me rastin e lidhjes së kontratës nuk ka marrë pjesë as personalisht, as përmes përfaqësuesit me prokurë. Pra qartë vertetohet se kjo marrëdhënie kontraktuale e polisës së sigurimit, nuk ka efekt të drejtpërdrejtë e as të tërthortë ndaj palëve nënshkruese të kontratës, mirëpo efekti i saj prodhon efekte ndaj palëve të treta, andaj përderisa nuk prodhon efekte ndaj palëve kontraktuese nuk mund të prodhojë efekte as ndaj trashëgimtarëve. Pra nuk shpjegohet fare se si është fituar cilësia e personit të tretë dhe si ka mundur të bartet një e drejtë e cila nuk i takon”.*
27. *Andaj, parashtruesi i kërkesës argumenton se Gjykata Supreme pa ofruar arsytetime të plota dhe të duhura juridike lidhur me aplikimin e dispozitave ligjore, duke cenuar kështu sigurinë juridike në atë mënyrë që “fillimisht duke ngatërruar cilësinë e personit të tretë duke ia njohur të drejtën e zhdëmtimit të ndjerit e më pas duke ia deleguar këtë të drejtë trashëgimtarëve pa dhënë arsye se si i është njohur cilësia e personit të tretë e me pas si ka mundur të delegohet kjo e drejtë tek trashëgimtarët - paditësit.” Lidhur me këtë, parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se Gjykata Supreme është shmangur edhe nga praktika kombëtare dhe ndërkombëtare pa ofruar arsytetime të plota dhe të duhura juridike lidhur me zbatimin e dispozitave ligjore.*
28. *Lidhur me të drejtën për një vendim të arsyetuar parashtruesi i kërkesës i referohen edhe praktikës së GJEDNJ-së, specifikisht rastit *Spuminen kundër Finlandës*, Aktgjykimi i 1 korrikut 2003, *Hajianastassiu kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992, të cilat elaborojnë standardet e një vendimi të arsyetuar. Parashtruesi i kërkesës po ashtu thekson se e drejta për një vendim të*

arsyetuar është elaboruar edhe nga Gjykata Kushtetuese, duke theksuar kështu rastet e Gjykatës KI55/09 dhe KI135/14.

29. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme nuk përmban fare arsyetim lidhur me shpenzimet e procedurës së krijuar në vlerë prej 4,598.00 euro duke cenuar kështu nenin 450 dhe 452 të LPK-së pasi shpenzimet janë krijuar për nxjerrjen e ekspertizës financiare në emër të mbajtjes së humbur e cila tashmë është refuzuar nga të gjitha instancat gjyqësore dhe në kundërshtim me tarifën e Odës së Avokatëve.
30. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata Supreme ka vendosur në kundërshtim me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme 265/2020 të 2 dhjetorit 2020, kur ka vendosur lidhur me kamatën pasi momenti i fillimit të rrjedhës së kamatës tek dëmet materiale fillon nga momenti i vendosjes së gjykatës së shkallës së parë e jo sikur gabimisht është vlerësuar sipas aktgjykimit të atakuar, nga dita kur është bërë ekspertiza. Për pasojë, kjo ka rezultuar me cenimin e dispozitës së nenit 277 të LMD-së të vitit 1978, respektivisht nenit 370 të LMD-së të vitit 2012.
31. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës lidhur me të drejtën për mbrojtje të pronës, mbi bazën e njëjtë të argumenteve duke përfshirë moszbatimin e duhur të legjislacionit, thekson se i është shkelur edhe e drejta për mbrojtje të pronës e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës.
32. Në fund, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të konstatojë se ka pasur shkelje të neneve 31 dhe 46 të Kushtetutës, të anulojë Aktgjykimin e Gjykatës Supreme Rev.nr.445/20 të 10 shkurtit 2021 dhe rastin ta kthejë në rishqyrtim në Gjykatën Supreme.

Dispozitat relevante kushtetuese dhe ligjore

Ligji për Marrëdhëniet e detyrimeve i viti 1978

“Neni 178

Përgjegjësia në rast aksidenti të shkaktuar nga automjetet në lëvizje

- 1.Në rast të aksidentit të shkaktuar nga mjeti motorik dhe shkaktuar tërësisht si pasojë e pronarit, rregullat e dëmshpërblimit bazuar në faj aplikohen.*
- 2 Nëse të dy palët janë fajtor, secili pronar është përgjegjës për lëndimet apo dëmet e pësuar nga ta në proporcion me shkallën e fajit të tyre.*
- 3. Nëse asnjëra nga palët nuk është fajtor, pronarët duhet të ndajnë përgjegjësinë në pjesë të barabarta, përveç nëse arsyet e barazisë kërkojnë për të vendoset ndryshe.*

4. Pronarët e mjeteve motorike, duhet të jenë së bashku përgjegjës për dëmet e shkaktuara palëve të treta.
[...]

III Kamatëvonesa

Kur ka debitim

Neni 277

1. Debitoi që vonon me pëmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos kryegjësë, edhe kamatin sipas shkallës, e cila në vendin e përmbyshjes paguhet në depozitimet e kursimit me të parë.
2. Për detyrimet në të holla të rezultuar nga kontrata në ekonomi kamatëvonesën e cakton Këshilli Ekzekutiv Federativ.
3. Në qoftë se shkalla e kamatës kontraktuese është më e lartë nga se është shkalla e kamatëvonesës së parashikuar në paragrafin paraparak të këtij neni, ajo rrjedh edhe pas vonesës së debitorit.”

Ligji nr. [04/L-077] mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve

“Neni 74

Bartja e autorizimeve

1. Përfaqësuesi nuk mund të bëjë bartjen e autorizimeve ta veta në tjetrin, përveç nëse kjo i është lejuar me ligj ose me kontratë.
2. Përjashtimisht, ai mund ta bëjë këtë, në qoftë se është i penguar nga rrethanat që punën ta kryejë vetë, kurse interesat e të përfaqësuarit kërkojnë ndërmarrjen pa vonesë të veprimit juridik.
[...]

Neni 370

Heqja dorë, hedhja poshtë ose refuzimi i padisë

1. Ndërprerja e parashkrimit e bërë me paraqitjen e padisë ose me ndonjë veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrur kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës, konsiderohet se nuk ka filluar po qe se kreditori heq dorë nga padia ose veprimi të cilin e ka ndërmarrë.
2. Konsiderohet se nuk ka pasur ndërprerje, në qoftë se padia e kreditorit ose kërkesa e tij është hedhur poshtë apo refuzuar ose në qoftë se masa e kërkuar ose e ndërmarrur e përmbarimit apo e sigurimit është shpallur e pavlefshme

Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm të Autopërgjegjësisë miratuar nga Bordi Drejtues i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

Neni 1

Kushtet e përgjithshme dhe rregullimi

“[...]

- 1.8 *Kategoria e “personit të tretë”*

Personat në vijim nuk kanë të drejtë zhdemtimi në bazë të sigurimit të detyrueshëm të autopërgjegjësisë, d.m.th. nuk e kanë statusin e “personit të tretë”

[...]

c. pronari, bashkëpronari dhe shfrytëzuesit e tjerë të regjistruar të automjetit, në raste se bëhen dëme në pasurinë e tyre.”

Ligji Nr. 03/L-006 për Procedurën Kontestimore

Neni 452

[...]

452.1 Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqfituese, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet gjyqësore.

452.2 Po që se paditësi vetëm pjesërisht ka sukses në procesin gjyqësor, atëherë gjykata mundet, duke marrë parasysh suksesin e arritur, të caktojë që secila palë t’i bartë shpenzimet e veta apo që njëra palë t’ia shpërblej tjetrës, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, pjesën proporcionale të shpenzimeve.

452.3 Gjykata mund të vendos që njëra palë t’i shpërblej të gjitha shpenzimet që kanë pasur pala kundërshtare dhe ndërhyrësi që i është bashkuar, në qoftë se pala kundërshtare nuk ka pasur sukses vetëm në pjesën proporcionalisht të pa rëndësishme të kërkesës së vet, kurse për shkak të kësaj pjese nuk janë krijuar shpenzime të veçanta.
[...]

Mendim Juridik për Kamatën e miratuar në mbledhjen e përgjithshme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës i 1 dhjetorit 2020, i bazuar në nenin 26 paragrafi 1 pika 1.4 të Ligjit për Gjykatat

PJESA E PARË Ligji i aplikueshëm

- I. Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Gazeta Zyrtare e RSFJ-së, nr.29/78, 39/85,57/89).*
- II. Për marrëdhëniet që kanë lindur pas datës 19.12.2012, për kamatën zbatohen dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve, nr. 04/L-077, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.19/19, datë 19.06.2012.*

PJESA E DYTË

IV. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur para datës 20.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat caktohet si për mjetet e depozituara në bankë, mbi një vit, pa destinim të caktuar.*

V. [...]]

VI. *Për marrëdhëniet e detyrimeve që kanë lindur pas datës 19.12.2012, shkalla/lartësia e kamatëvonesës vjetore për të gjitha kërkesat do të caktohet në lartësi prej 8 %, përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë.*

IX. *Për kërkesat e kreditorëve për rimbursim të dëmit nga të gjitha bazat e përgjegjësisë kur kreditorët kanë të drejtë në rimbursim të dëmit, lartësia e kamatës caktohet sipas pikës IV (katër) dhe VI (gjashtë) të këtij mendimi juridik, varësisht se cili ligj është zbatuar (ka qenë në fuqi) kur kreditori në cilësinë e debitorit ka përmbushur detyrimin ndaj palës së tretë.*

Situatat kur aplikohet norma e interesit vjetor prej 12 %:

- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në persona, nuk trajtohen në afat prej 60 ditësh;*
- *Kur kërkesat e paraqitura tek Kompanitë e Sigurimeve, për dëmin në pasuri, nuk trajtohet brenda 15 ditësh.”*
[...]

PJESA E TRETE

Periudha e pagesës së kamatës:

XIV. *Pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material (demi i zakonshëm apo fitimi i munguar), kamata fillon që të rrjedhë nga data e parashtrimit të kërkesës se kreditorit për kompensim (e pranuar nga debitori) dhe në rast të mos parashtrimit të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon që të rrjedhë nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën e plotë.*

[...]"

Pranueshmëria e kërkesës

33. *Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe të parapara me Rregullore të punës.*
34. *Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara], të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:*

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

35. Gjykata gjithashtu shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të kërkuara me nenet 47 [Kërkesat individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 47
[Kërkesa individuale]

“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.

2. Individ i mund të ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49
[Afati]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”.

36. Në këtë drejtim, Gjykata fillimisht vëren se parashtruesi i kërkesës ka të drejtë të paraqesë ankesë kushtetuese, duke u thirrur në shkelje të pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të tij, që vlejné për individët dhe personat juridikë (shih rastin e Gjykatës KI41/09, me parashtrues *Universiteti AAB-RIINVEST L.L.C.*, Aktvendimi për papranueshmëri i 3 shkurtit 2010, paragrafi 14; dhe KI35/18, me parashtrues *“Bayerische Versicherungsverband”*, Aktgjykim i 11 dhjetorit 2019, paragrafi 40).
37. Për sa i përket përmbushjes së kriterëve të tjera të pranueshmërisë, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës është palë e autorizuar; i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion; e ka qartësuar aktin e autoritetit publik kushtetutshmërinë e të cilit e konteston, konkretisht Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr.445/2020, të 10 shkurtit 2021; i ka specifikuar të drejtat kushtetuese të cilat pretendon se i janë cenuar; si dhe e ka dorëzuar kërkesën brenda afatit ligjor.

38. Përveç kësaj, Gjykata gjithashtu duhet të shqyrtojë nëse parashtuesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39 (2) i Rregullores së punës përcakton që:

“(2) Gjykata mund ta konsiderojë kërkesën të papranueshme, nëse kërkesa është qartazi e pabazuar, sepse parashtuesi nuk dëshmon dhe nuk mbështetë në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

39. Gjykata fillimisht vëren se rregulli i lartcekur, bazuar në praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ) dhe të Gjykatës, i mundëson kësaj të fundit që t'i shpallë kërkesat të papranueshme për arsye që ndërlidhen me meritat e një rasti. Më saktësisht, bazuar në këtë rregull, Gjykata mund të shpallë një kërkesë të papranueshme bazuar në dhe pas vlerësimit të meritave të saj, përkatësisht nëse e njëjta vlerëson se përmbajta e kërkesës është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës (shih rastin KIO4/21, parashtuese *Nexhmije Makolli*, Aktvendim për papranueshmëri i 12 majit 2021, paragrafi 26, gjithashtu rastin KI175/20, parashtuese *Agjencia Kosovare e Privatizimit*, Aktvendim për papranueshmëri i 27 prillit 2021, paragrafi 37).
40. Bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por edhe të Gjykatës, një kërkesë mund të shpallet e papranueshme si „qartazi e pabazuar“ në tërësinë e saj ose vetëm përkritazi me ndonjë pretendim specifik që një kërkesë mund të ngërthejë. Në këtë drejtim, është më e saktë t'iu referohet të njëjtave si “pretendime qartazi të pabazuara”. Këto të fundit, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, mund të kategorizohen në katër grupe të veçanta: (i) pretendime që kualifikohen si pretendime “*të shkallës së katërt*”; (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkëljes*”; (iii) pretendime “*të pambështetura apo të paarsyetuara*”; dhe në fund, (iv) pretendime “*konfuze dhe të paqarta*” (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 27 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 38).
41. Në kontekst të vlerësimit të pranueshmërisë së kërkesës, përkatësisht, vlerësimit nëse kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, Gjykata, fillimisht do të rikujtojë thelbin e rastit që ngërthen kjo kërkesë dhe pretendimet përkatëse të parashtuesit të kërkesës, në vlerësimin e të cilave, Gjykata do të aplikojë standardet e praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, në harmoni me të cilën, në bazë të nenit 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, ajo është e detyruar të interpretojë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kushtetutë (shih rastin KIO4/21, cituar më lart, paragrafi 28 si dhe rastin KI175/20, cituar më lart, paragrafi 39).
42. Para se Gjykata të trajtojë pretendimet e parashtuesit të kërkesës për shkelje kushtetuese, Gjykata thekson se thelbi i rastin që ngërthen kjo kërkesë ndërlidhet me një aksident të trafikut që kishte ndodhur në rrugën rajonale Rozhajë –Pejë, në të cilin ishte përfshirë vetura BMW me tabela suedeze e siguruar me “sigurim kufitar” për mbulimin e dëmeve ndaj palëve të treta tek parashtuesi i kërkesës. Pronar i kësaj veture ishte i ndjeri B.G. (djali i paditësve) ndërsa veturën ishte duke e drejtuar G.B. dhe i cili gjatë drejtimit të veturës

kishte humbur kontrollin e veturës me ç'rast si pasojë e aksidentit kishin humbur jetën drejtuesi i veturës G.B., pronari i veturës B.G., si dhe B.Sh. Padiësit, prindërit e të ndjerit B.G., kishin paraqitur padi kundër parashtruesit të kërkesës duke kërkuar nga kjo e fundit zhdëmtim material si pasojë e aksidentit të lartcekur, dhe atë: i) në emër të veturës së dëmtuar shumë prej 10.394.00 euro; ii) në emër të mbajtjes së humbur ndaj padiësve dhe atë padiësit A.G. shumë prej 62.825.00 dhe padiësës G.G., shumë prej 85.010.00 euro; si dhe iii) shpenzimet procedurale në shumë prej 4.598.00 euro.

43. Gjykata Themelore refuzoi si të pabazuar padinë e padiësve ndaj parashtruesit të kërkesës, pasi mes tjerash, gjeti se sipas legjislacionit në fuqi, pronari i automjetit (dhe rrjedhimisht trashëgimtarët e tij/saj), nuk ka të drejtë në kompensimin e automjetit të dëmtuar, pasi nuk konsiderohen person i "tretë" për qëllim të kompensimit të dëmit. Vendimi i Gjykatës Themelore u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit. Megjithatë, Gjykata Supreme duke vendosur lidhur me revizionin e padiësve, përmes Aktgjykimit [Rev.nr.445/2020] e pranoi pjesërisht revizionin e padiësve, ndryshoi Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore, dhe detyroi parashtruesin e kërkesës që padiësve, i) në emër të shpërblimit të dëmit material për dëmtimin e veturës, t'ua kompensojë shumë prej 10,394.00 euro me kamatë që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar duke e llogaritur nga data e përpilimit të ekspertizës së 27 korrikut 2012; ii) t'ua kompensojë shpenzimet procedurale në shumë prej 5,598.00 euro; dhe (iii) në pjesën tjetër, refuzoi revizionin si të pabazuar.

Lidhur me të drejtën për gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së

44. Gjykata vëren se lidhur me shkeljen e të drejtës për një gjykim të drejtë të garantuar me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ, parashtruesi i kërkesës, në thelb pretendon se Gjykata Supreme:

a) nuk ka dhënë një arsyetim të duhur dhe të plotë lidhur me atë se:

- i) pse i ka njohur padiësve statusin e "personit të tretë" përkundër faktit që sigurimi të cilin e posedonte automjeti i aksidentuar nuk i mbulonte dëmet e shkaktuara pronarit të automjetit (të birit të ndjerë të padiësve), dhe rrjedhimisht as të trashëgimtarëve të tij, në këtë rast padiësve; dhe
- ii) pse shpenzimet procedurale i janë ngarkuar parashtruesit të kërkesës, përveç për dëmin në automjet, edhe lidhur me ekspertizën që ka të bëjë me mbajtjen e humbur i cili pretendim i padiësve ishte refuzuar si i pabazuar edhe nga Gjykata Supreme; dhe

b) ka aplikuar gabimisht ligjin, konkretisht në kundërshtim me Mendimin Juridik për Kamatë të Gjykatës Supreme, të 1 dhjetorit 2020, dhe legjislacionin për marrëdhëniet e detyrimeve. Kamata është llogaritur nga

dita e nxjerrjes së ekspertizës dhe jo nga dita e nxjerrjes së Aktgjyimit të Gjykatës Themelore, ashtu si kërkohet me legjislacionin në fuqi.

a) Përkitazi me pretendimin se Gjykata Supreme nuk ka dhënë arsyetim të duhur dhe të plotë lidhur me atë se: i) pse i ka njohur paditësve statusin e “personit të tretë”; dhe ii) pse shpenzimet procedurale i janë ngarkuar parashtruesit të kërkesës, përveç për dëmin në automjet, edhe lidhur me ekspertizën që ka të bëjë më mbajtjen e humbur

Parimet e përgjithshme lidhur me arsyetimin e vendimeve gjyqësore

45. Përkitazi me të drejtën për një vendim të arsyetuar gjyqësor të garantuar përmes nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, Gjykata fillimisht thekson se ajo tashmë ka një praktikë të konsoliduar gjyqësore. Kjo praktikë është ndërtuar duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përfshirë por duke mos u kufizuar në rastet *Hadjianastassiou kundër Greqisë*, Aktgjykim i 16 dhjetorit 1992; *Van de Hurk kundër Holandës*, Aktgjykim i 19 prillit 1994; *Hiro Balani kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994; *Higgins dhe të tjerët kundër Francës*, Aktgjykimi i 19 shkurtit 1998; *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykimi i 21 janarit 1999; *Hirvisaari kundër Finlandës*, Aktgjykim i 27 shtatorit 2001; *Suominen kundër Finlandës*, Aktgjykim i 1 korrikut 2003; *Buzescu kundër Rumanisë*, Aktgjykim i 24 majit 2005; *Pronina kundër Ukrainës*, Aktgjykim i 18 korrikut 2006; dhe *Tatishvili kundër Rusisë*, Aktgjykimi i 22 shkurtit 2007. Për më tepër, parimet themelore sa i përket të drejtës për një vendim të arsyetuar gjyqësor janë elaboruar po ashtu në rastet e kësaj Gjykate, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në KI22/16, me parashtrues *Naser Husaj*, Aktgjykim i 9 qershorit 2017; KI97/16, me parashtrues “*IKK Classic*”, Aktgjykim i 9 janarit 2018; KI143/16, me parashtrues *Muharrem Blaku dhe të tjerët*, Aktvendim për papranueshmëri i 13 qershorit 2018; KI24/17, me parashtrues *Bedri Salihu*, Aktgjykim i 27 majit 2019; KI35/18, me parashtrues “*Bayerische Versicherungsverband*”, cituar më lart, dhe KI227/19, me parashtrues *N.T. “Spahia Petrol”*, cituar më lart, paragrafi 45.
46. Në parim, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, garancitë e mishëruara në nenin 6 të KEDNJ-së përfshijnë detyrimin që gjykatat të japin arsye të mjaftueshme për vendimet e tyre (shih rastin e GJEDNJ-së, *H. kundër Belgjikës*, Aktgjykimi i 30 nëntorit 1987, paragrafi 53). Një vendim i arsyetuar u tregon palëve se çështja e tyre është dëgjuar me të vërtetë, dhe për pasojë kontribuon në një pranueshmëri më të madhe të vendimeve (shih rastin e GJEDNJ-së *Magnin kundër Francës*, Vendim i 10 majit 2012, paragrafi 29). Kjo praktikë gjyqësore gjithashtu përcakton se përkundër faktit që një gjykatë ka një liri të caktuar të vlerësimit lidhur me përzgjedhjen e argumenteve dhe dëshmive, ajo është e detyruar të justifikojë aktivitetet dhe vendimmarrjen e saj duke dhënë arsye përkatëse (shih rastet e GJEDNJ-së: *Suominen kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 36; *Carmel Saliba kundër Maltës*, Aktgjykim i 24 prillit 2017, paragrafi 73; shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues *N.T. “Spahia Petrol”*, cituar më lart, paragrafi 46). Për më tepër, vendimet duhet të

jenë të arsyetuara në atë mënyrë që t'u mundësojë palëve të shfrytëzojnë në mënyrë efektive çdo të drejtë ekzistuese të ankesës (shih rastin e GJEDNJ-së, *Hirvisaari kundër Finlandës*, cituar më lart, paragrafi 30).

47. Thënë këtë, neni 6 i KEDNJ-së i detyron gjykatat të japin arsye për vendimet e tyre, por kjo nuk do të thotë se kërkohet përgjigje e detajuar lidhur me secilin argument (shih rastet e GJEDNJ-së *Van de Hurk kundër Holandës*, cituar më lart, paragrafi 61; *García Ruiz kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 26; *Jahnke dhe Lenoble kundër Francës*, Vendim i 29 gushtit 2000; *Perez kundër Francës*, Aktgjykim i 12 shkurtit 2004, paragrafi 81; dhe shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues N.T. "*Spahia Petrol*", cituar më lart, paragrafi 47). Masa në të cilën zbatohet ky detyrim mund të ndryshojë në varësi të natyrës së vendimit dhe duhet të përcaktohet në dritën e rrethanave të secilit rast (shih rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, Aktgjykim i 9 dhjetorit 1994, paragrafi 29; *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 27; dhe shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues N.T. "*Spahia Petrol*", cituar më lart, paragrafi 47). Për shembull, një gjykatë apeli, mundet, në parim, të refuzojë një ankesë duke miratuar arsyet e vendimit të gjykatës më të ulët, megjithatë edhe një vendim i tillë duhet të përmbajë mjaftueshëm arsyetim për të treguar se gjykata përkatëse nuk ka miratuar konstatimet e arritura nga një gjykatë më e ulët pa konsideratë të mjaftueshme (shih, ndër të tjera, rastin e GJEDNJ-së, *Tatishvili kundër Rusisë*, cituar më lart, paragrafi 62; shih po ashtu rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues N.T. "*Spahia Petrol*", cituar më lart, paragrafi 47).
48. Megjithatë, bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, nga gjykatat kërkohet që të shqyrtojnë dhe japin përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me: (i) pretendimet dhe argumentet thelbësore të palës (shih, rastet e GJEDNJ-së, *Buzescu kundër Rumanisë*, cituar më lart, paragrafi 67; dhe *Donadze kundër Gjeorgjisë*, Aktgjykim i 3 marsit 2006, paragrafi 35); (ii) pretendimet dhe argumentet që janë vendimtare për rezultatin e procedurës (shih, rastet e GJEDNJ-së: *Ruiz Torija kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 30; dhe *Hiro Balani kundër Spanjës*, cituar më lart, paragrafi 28); ose (iii) pretendimet në lidhje me të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë dhe KEDNJ (shih rastin e GJEDNJ-së, *Wagner dhe J.M.W.L. kundër Luksemburgut*, Aktgjykim i 28 qershorit 2007, paragrafi 96 dhe referencat në të; dhe gjithashtu shih rastin e Gjykatës, KI227/19, me parashtrues N.T. "*Spahia Petrol*", cituar më lart, paragrafi 48).

Aplikimi i këtyre parimeve në rrethanat e rastit konkret:

- i) lidhur me atë se pse Gjykata Supreme i ka njohur paditësve statusin e "personit të tretë" përkundër faktit që sigurimi të cilin e posedonte automjeti i aksidentuar nuk i mbulonte dëmet e shkaktuara pronarit të automjetit (birit të paditësve), dhe rrjedhimisht as të trashëgimtarëve të tij, në këtë rast paditësve;
49. Në lidhje me rastin konkret, në raport me pretendimin e parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme pa dhënë një arsyetim të duhur dhe të plotë lidhur

me atë se pse i ka njohur paditësve statusin e “personit të tretë” përkundër faktit që sigurimi të cilin e posedonte automjeti i aksidentuar nuk i mbulonte dëmet e shkaktuara pronarit të automjetit (birit të paditësve), Gjykata vëren se Gjykata Supreme, kishte arsyetuar se:

“Rregulla 3 mbi ndryshimin e Rregullit për sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia sikurse edhe Ligji mbi sigurimin e detyrueshëm nga auto përgjegjësia (nr.04/L-O 18) kanë pranuar principin e përcaktimit negativ të rrethit të personave të tretë, duke theksuar personat të cilët nuk kanë të drejtë të parashtrojnë kërkesën për shpërblimin e dëmit nga i siguruari. Sipas nenit 1.8 pika (c) të Rregullit 3, e cila ka qenë në fuqi kur ka ndodhur aksidenti i komunikacionit është përcaktuar që personat që nuk kanë të drejtë në shpërblimin e dëmit në bazë të sigurimit të detyrueshëm të auto përgjegjësise, që nuk kanë statusin e personit të tretë, janë: pronari, bashkëpronari dhe shfrytëzuesi etj. të regjistruar të automjetit nëse bëhen dëme në pasurinë e tyre. Nga interpretimi ligjor dhe gramatikor i dispozitës së cituar më lartë, qartë rezulton se kur pronari i automjetit është bashkudhëtar i njihet e drejta për shpërblimin e dëmit dhe statusi juridik nuk mund të jetë ndryshe nga statusi i udhëtarëve të tjerë, për këtë arsye e drejta shpërblimit të dëmit në automjet duhet të pranohet. Nga kjo mund të kolaudohet se pronari i automjetit ka të drejtë në shpërblimin e dëmit nëse ka qenë bashkudhëtar në automjet. Për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në automjet, paditësit kanë të drejtë në shpërblimin e dëmit në bazë të nenit 178 të LMD-së [Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve], dhe se në rastin konkret lartësinë e automjetit të dëmtuar e ka vlerësuar eksperti i makinerisë [A.H.] që edhe sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme është vlerësim real dhe i pranuar, e të cilën shumë është i obliguar që e paditura t’ua kompensojë paditësve.”

50. Rrjedhimisht, Gjykata Supreme konstatoi se sipas legjislacionit në fuqi, vetëm personat e cekur specifikisht, duke përfshirë vet pronarin e automjetit janë persona të tretë, rrjedhimisht nuk u takon kompensimi. Megjithatë, Gjykata Supreme theksoi se pronari i automjetit nuk konsiderohet “person i tretë” kur ai nuk ka drejtuar mjetin kur i njëjti është bashkudhëtar në automjetin e siguruar e të cilin e drejton një person tjetër. Këtë qëndrim Gjykata Supreme e kishte bazuar në interpretimin e dispozitave ligjore të Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe dispozitat relevante të LMD-së së vitit 1978.
51. Nga sa më sipër, Gjykata vë në pah se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetim lidhur me pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës, që ndërlidhet me përcaktimin e “personit të tretë”, dhe se, në përputhje me rrethanat e rastit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme është arsyetuar bazuar në interpretimin e legjislacionin në fuqi, konkretisht nenit 1.8, pika (c) të Rregullit 3 mbi ndryshimin e Rregullit për Sigurimin e Detyrueshëm nga Autopërgjegjësia dhe nenit 178 të LMD-së të vitit 1978. Në këtë kontekst, Gjykata Supreme ka dhënë përgjigje specifike dhe të qarta në lidhje me pretendimin dhe argumentin thelbësor të parashtruesit se pronari i automjetit nuk mund të përfitoj kompensim në cilësi të personit të tretë në rast se ndodh aksidenti nga vetura e siguruar, duke përfshirë edhe rastet ku ai/ajo nuk drejton mjetin në fjalë.

Gjykata konsideron se në përputhje me rrethanat e rastit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme lidhur me përcaktimin e “personit të tretë” është arsyetuar.

52. Prandaj, Gjykata konkludon se pretendimi i parashtruesit të kërkesës se Gjykata Supreme pa dhënë një arsyetim të duhur dhe të plotë lidhur me atë se pse i ka njohur paditësve statusin e “personave të tretë” përkundër faktit që sigurimi të cilin e posedonte automjeti i aksidentuar nuk i mbulonte dëmet e shkaktuara pronarit të automjetit (birit të paditësve), dhe rrjedhimisht as të trashëgimtarëve të tij është (ii) pretendim që kategorizohet me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” dhe si i tillë, ky pretendim i parashtruesit të kërkesës është qartazi i pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores.

ii) *Përkitazi me pretendimin se Gjykata Supreme nuk ka arsyetuar se pse shpenzimet procedurale i janë ngarkuar parashtruesit të kërkesës, përveç për dëmin në automjet, edhe lidhur me ekspertizën që ka të bëjë më mbajtjen e humbur i cili pretendim i paditësve ishte refuzuar si i pabazuar edhe nga Gjykata Supreme;*

53. Sa i përket pretendimit të parashtruesit të kërkesës se shpenzimet procedurale i janë ngarkuar parashtruesit të kërkesës edhe lidhur me ekspertizën që ka të bëjë më mbajtjen e humbur i cili pretendim ishte refuzuar si i pabazuar edhe nga Gjykata Supreme, kjo e fundit kishte arsyetuar se:

“kjo gjykatë vendosi që të gjitha shpenzimet t’i bartë e paditura duke llogaritur lartësinë e shpenzimeve sipas listës së precizuar nga i autorizuari i paditësve e llogaritur sipas tarifës së avokateve dhe duke marrë parasysh faktin se në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk ka pasur shpenzime të veçanta, prandaj si u tha me lartë shpenzimet e procedurës kontestimore duhet t’i bartë e paditura dhe atë në kuptim të nenit 452.2 të LPK-së.”

54. Për më tepër, Gjykata vëren se nga dosja e lëndës ashtu si është dorëzuar nga vet parashtruesi i kërkesës, është përfshirë vetëm një ekspertizë (Ekspertiza për Llogaritjen e Dëmit material draftuar nga Eksperti i makinerisë A.H., e datës 27 gusht 2012) e cila ka të bëjë më dëmin material të shkaktuar si rezultat i aksidentin në automjetin e aksidentuar. Andaj kjo ekspertizë ka të bëjë me pjesën e padisë që ndërlidhet me dëmin e shkaktuar material, lidhur me të cilën Gjykata Supreme ka aprovuar padinë e paditësve.

55. Nga sa më sipër, Gjykata vë në pah se Gjykata Supreme ka dhënë arsyetim lidhur me pretendimin specifik të parashtruesit të kërkesës, duke theksuar se duke marrë parasysh faktin se në pjesën refuzuese të kërkesëpadisë nuk ka pasur shpenzime të veçanta, shpenzimet e procedurës kontestimore duhet t’i bartë parashtruesi i kërkesës, si i paditur. Këtë qëndrim Gjykata Supreme e kishte bazuar në interpretimin e dispozitave ligjore të LPK-së, konkretisht nenin 452.2 të saj.

56. Gjykata konsideron se në përputhje me rrethanat e rastit, Aktgjykimi i Gjykatës Supreme lidhur me shpenzimet procedurale është arsyetuar. Rrjedhimisht, edhe

këto pretendime janë (ii) pretendime që kategorizohen me një “mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes” dhe si të tilla, këto pretendime të parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuar në baza kushtetuese, siç përcaktohet me paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

b) Përkitazi me pretendimin se Gjykata Supreme në kundërshtim me ligjin, respektivisht, Mendimin Juridik për Kamatë të Gjykatës Supreme, të 1 dhjetorit 2020, kamata është llogaritur nga dita e nxjerrjes së ekspertizës dhe jo nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore

57. Parashtruesi i kërkesës po ashtu pretendon se në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, në rastin konkret kamata është llogaritur nga dita e nxjerrjes së ekspertizës dhe jo nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit të Gjykatës Themelore, ashtu si kërkohet me legjislacionin në fuqi. Kjo, sipas parashtruesit të kërkesës, ka rezultuar në shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë, si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit, konkretisht në kundërshtim me Mendimin e lartcekur të vet Gjykatës Supreme lidhur me përcaktimin e kamatës sipas legjislacionit për marrëdhëniet e detyrimeve. Lidhur me këtë ai thirren në nenin 277 të LMD-së të vitit 1978 dhe nenin 377 të LMD-së të vitit 2012.
58. Në rastin konkret, Gjykata vëren se Gjykata Supreme pasi aprovoi pjesën e padisë së paditësve, që ka të bëjë me shpërblimin e dëmit material për dëmtimin e veturës, vendosi se parashtruesi i kërkesës detyrohet t’ia paguajë paditësve shumën prej 10,394 [euro], me kamatë që paguajnë bankat në mjetet e deponuara mbi një vit pa destinim të caktuar “*duke llogaritur nga data e përpilimit të ekspertizës.*”
59. Lidhur me këtë, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës thjeshtë i referohet Mendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme, dhe citon nenet e lartcekura të LMD-së duke theksuar se ky qëndrim i Gjykatës Supreme sipas Aktgjykimit është në kundërshtim me Mendimin e lartcekur të vet Gjykatës Supreme, duke theksuar se kamata duhet të ishte caktuar nga dita e nxjerrjes së vendimit të shkallës së parë dhe jo nga dita e nxjerrjes së ekspertizës.
60. Megjithatë, në këtë kontekst Gjykata i referohet Pjesës së Tretë të Mendimit të lartcekur të Gjykatës Supreme që përcakton se “*Pavarësisht se kur është lindur marrëdhënia e detyrimeve për kërkesat që i referohen dëmit material (demi i zakonshëm apo fitimi i munguar), kamata fillon që të rrjedhë nga data e parashtrimi të kërkesës së kreditorit për kompensim (e pranuar nga debitori) dhe në rast të mos parashtrimi të kërkesës nga ana e kreditorit për kompensim, atëherë kamata fillon që të rrjedh nga data e parashtrimi të padisë e deri në pagesën e plotë*”.
61. Lidhur me këtë, Gjykata vëren se as Mendimi i lartcekur i Gjykatës Supreme e as dispozitat e neneve specifike të LMD-së të vitit 1978 (i aplikueshëm në kohën e ndodhjes së aksidentit) në të cilat thirret parashtruesi i kërkesës nuk kanë

përcaktuar se kamata llogaritet nga dita e nxjerrjes së Aktgjykimit të shkallës së parë, kur kemi të bëjmë me dëmin material, siç është rasti konkret.

62. Andaj, Gjykata nuk gjen që me rastin e parashtresit të kërkesës llogaritja e kamatës është bërë në kundërshtim me Mendimin juridik të Gjykatës Supreme apo dispozitat e nenit 277 të LMD-së të vitit 1978.
63. Në lidhje me këtë, Gjykata duhet të përsërisë se parashtresi i kërkesës në kërkesën para saj, në thelb, parashton pretendime në lidhje me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga gjykatat e rregullta, respektivisht në kundërshtim me Mendim e lartcekur të Gjykatës Supreme dhe LMD-në.
64. Në lidhje me këtë, Gjykata duke u bazuar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, por duke marrë parasysh edhe veçoritë e saj, siç janë përcaktuar përmes KEDNJ-së dhe praktikës së Gjykatës (shih rastin e Gjykatës KI92/19, parashtres „HUBO INTERNATIONAL N.V.“, Aktvendim për papranueshmëri i 25 marsit 2021, paragrafi 59), parimin e subsidiaritetit dhe doktrinën e shkallës së katërt, ajo vazhdimisht e ka theksuar dallimin në mes të “kushtetutshmërisë” dhe “ligjshmërisë” dhe ka pohuar se nuk është detyrë e saj të merret me gabime të fakteve ose interpretimit dhe aplikimit të gabuar të ligjit, që pretendohet se janë bërë nga një gjykatë e rregullt, përveç dhe për aq sa gabimet e tilla mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë dhe/ose me KEDNJ (shih, në këtë kontekst, ndër të tjera, rastet e Gjykatës KI128/18, parashtres: *Shoqëria Aksionare Limak Kosovo International Airport S.H.A.*, “Adem Jashari”, Aktvendim i 28 qershorit 2019, paragrafi 55; KI62/19, parashtres: *Gani Gashi*, Aktvendim për papranueshmëri i 19 dhjetorit 2019, paragrafët 56-57; KI110/19, parashtres: *Fisnik Baftijari*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 nëntorit 2019, paragrafi 40).
65. Gjykata gjithashtu ka pohuar vazhdimisht se nuk është roli i kësaj Gjykate të rishikojë konkluzionet e gjykatave të rregullta në lidhje me gjendjen faktike dhe zbatimin e të drejtës materiale dhe se ajo nuk mund të vlerësojë vetë faktet të cilat e kanë bërë një gjykatë të rregullt të marrë një vendim e jo një tjetër. Në të kundërtën, Gjykata do të vepronte si gjykatë e “shkallës së katërt”, që do të rezultonte në shpërfilljen e kufijve të vendosur në juridiksionin e saj (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *García Ruiz kundër Spanjës*, Aktgjykim i 21 janarit 1999, paragrafi 28 dhe referencat e përdorura aty; dhe shih, gjithashtu rastet e Gjykatës KI128/18, cituar më lart, paragrafi 56; dhe KI62/19, cituar më lart, paragrafi 58).
66. Gjykata gjithashtu thekson faktin se në vlerësimin e pretendimeve “të shkallës së katërt” e që ndërlidhen me shkelje të pretenduara të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, ajo gjithashtu vazhdimisht ka theksuar se “drejtësia” e kërkuar nga nenet e lartpërmendura nuk është një drejtësi “substanciale”, por drejtësi “procedurale”. Ky koncept kryesisht në aspektin praktik, në parim, nënkupton (i) mundësinë e procedurave kontradiktore; (ii) mundësinë e palëve që në faza të ndryshme të kësaj procedure, të paraqesin argumente dhe dëshmi që i konsiderojnë të rëndësishme për rastin përkatës; (iii) mundësinë e kontestimit efikas të argumenteve dhe dëshmive të paraqitura

nga pala kundërshtare; dhe (iv) të drejtën që argumentet e tyre të cilat, shikuar në mënyrë objektive, janë të rëndësishme për zgjidhjen e rastit, të dëgjohen dhe shqyrtohen nga gjykatat e rregullta në mënyrë të duhur; dhe se, për pasojë, procedura, marrë si tërësi, do të rezultonte si e drejtë (shih rastin e Gjykatës KI92/19, citur më lart, paragrafi 61). Për më tepër, vlerësimi i drejtësisë së një procedure në tërësinë e saj, është një ndër premisat kryesore të praktikës gjyqësore të Gjykatës dhe asaj të GJEDNJ-së (shih, në këtë kontekst, rastin e GJEDNJ-së *Barbera, Messeque dhe Jabardo kundër Spanjës*, Aktgjykim i 6 dhjetorit 1988, paragrafi 68; dhe rastet e Gjykatës, KI128/19, cituar më lart, paragrafi 58; dhe KI22/19, parashtruesi i kërkesës: *Sabit Ilazi*, Aktvendim për papranueshmëri i 7 qershorit 2019, paragrafi 42).

67. Në rrethanat e këtij rasti, Gjykata thekson se parashtruesi i kërkesës, përtej pretendimeve për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, si rezultat vendosjes lidhur me kamatën në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, respektivisht në kundërshtim me Mendimin Juridik të Gjykatës Supreme, nuk mbështet mjaftueshëm dhe as nuk argumenton para Gjykatës, se si ky interpretim i Gjykatës Supreme, mund të ketë qenë “qartazi i gabuar”, duke rezultuar në “konkluzione arbitrare” apo “qartazi të paarsyeshme” për parashtruesin e kërkesës apo se procedurat para gjykatave të rregullta, në tërësinë e tyre, mund të mos kenë qenë të drejta apo edhe arbitrare.
68. Prandaj, pretendimet e parashtruesit të kërkesës për aplikimin e gabuar të ligjit të zbatueshëm lidhur me datën e llogaritjes së kamatës cilësohen si pretendime që bien në kategorinë e “shkallës së katërt” dhe si të tilla, reflektojnë pretendime në nivel të “ligjshmërisë”, dhe nuk janë argumentuar në nivel të “kushtetutshmërisë”. Rrjedhimisht, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Lidhur me shkeljet e pretenduara të nenit 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës

69. Sa i përket shkeljeve të të drejtave garantuara me nenet 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës, Gjykata rikujton se sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, Gjykata e shpall kërkesën të papranueshme si qartazi të pabazuar në pajtim me kriterin (iii) të pretendimeve “*të pambështetura apo të paarsyetuara*” kur plotësohet një nga dy kushtet karakteristike, përkatësisht;
 - a) kur parashtruesi i kërkesës thjesht citon një ose disa dispozita të Konventës apo të Kushtetutës, pa shpjeguar mënyrën se si ato janë shkelur, përveç nëse kjo është qartazi e dukshme në bazë të fakteve dhe rrethanave të rastit (shih, në këtë drejtim, rastin e GJEDNJ-së *Trofimchuk kundër Ukrainës (vendim)* nr. 4241/03 i 31 majit 2005, shih gjithashtu *Baillard kundër Francës (vendim)* nr. 6032/04 i 25 shtatorit 2008);
 - b) kur parashtruesi i kërkesës nuk paraqet ose refuzon të paraqesë provat materiale me të cilat do t’i mbështeste pretendimet e tij (kjo

posaçërisht vlen për vendimet e gjykatave ose të autoriteteve të tjera të brendshme), përveç rasteve kur ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme që janë jashtë kontrollit të tij dhe të cilat e pengojnë ta bëjë këtë (për shembull, kur administrata e burgut refuzon t'ia paraqes Gjykatës dokumentet nga dosja e një të burgosuri për të cilin bëhet fjalë) ose nëse Gjykata vet nuk vendos ndryshe (shih rastin KI166/20, parashtrues, *Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale*, Aktvendim për papranueshmëri, 5 janar 2021, paragrafi 43).

70. Në rastin konkret, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të neneve 46 të Kushtetutës, por nuk arsyeton ose shpjegon se si ka ardhur deri te shkelja e këtij neni. Në fakt, parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të nenit 46 të Kushtetutës si rezultat i shkeljes së nenit 31 të Kushtetutës, konkretisht si rezultat i mos arsyetim të vendimit nga Gjykata Supreme.
71. Andaj, Gjykata konstaton se sa i përket pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të të drejtave të garantuara me nenin 46 të Kushtetutës, Gjykata konkludon se kërkesa duhet të deklarohet e papranueshme si qartazi e pabazuar, sepse këto pretendime cilësohen si pretendime që i takojnë kategorisë (iii) të pretendimeve “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”, Prandaj, të njëjtat janë qartazi të pabazuara në baza kushtetuese, siç përcaktohet në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

Përfundim

72. Gjykata konkludon se pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkeljen e të drejtave të garantuar me nenet 31 dhe 46 të Kushtetutës duhet të deklarohen të papranueshme në tërësi si qartazi të pabazuara sepse këto pretendime të parashtruesit të kërkesës kualifikohen si pretendime që hyjnë në kategorinë e (i) pretendimeve që kualifikohen si pretendime të “*shkallës së katërt*” ose (ii) pretendime që kategorizohen me një “*mungesë të dukshme ose evidente të shkeljes*” ose në kategorinë (iii) që kualifikohen si pretendime “*të pambështetura ose të paarsyetuara*”. Rrjedhimisht, kërkesa në tërësi duhet të shpallet e papranueshme si qartazi e pabazuar në baza kushtetuese, siç është përcaktuar në paragrafin (2) të rregullit 39 të Rregullores së punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullin 39 (2) të Rregullores së punës, më 20 tetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË SHPALLË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtarja raportuese



Selvete Gërxhaliu-Krasniqi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani